Cel +355 69 37 67 595
E-mail: green-studio@hotmail.com



Green-Studio

Elementet e sistemit të shfrytëzimit që parashikohet të perdoret ne kete objekt janë:

- Lartesia e shkalles se karrieres është 10m
- Gjeresia e sheshit të punes nga 12 m ne 35-40m
- Kendi i skarpates se shkalles $68^{\circ}20'$
- Kendi i shuarjes 52°
- Gjeresia e shesheve perfundimtare të shkalleve 3 m
- Kapaciteti ditor 100-130m³
- Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar;
- Rezimi i formacioneve rrethues dhe mineralit me gryerja të mekanizuar
- Rendimenti për dite pune efektive të punonjesve direkte 30-50m³/dp
- Rendimenti për dite pune efektive të punonjesve gjithsej 20-30 m³/dp

Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit dhe grafiket perkates të tyre

a) Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit

Pas kryerjes se zbulimit ne vitin e pare ne të gjithë siperfaqen e zonës se parashikuar, e cila ka

mbulese, po ne kete vit parashikohet të filloje dhe prodhimi i mineralit ne sasine e parshikuar prej 1000-1600 ton/vit. Radha e shfrytëzimit të shkalles se siperme te objektit do të jete nga lart poshtë, ndersa drejtim i shfrytëzimit nga veriperendimi drejt jugelindjes ndersa per pjesen tjeter te karrieres shfrytezimi parashikohet te behet nga qendra drejt ekstremeve të saj. Për realizimine prodhimit, aktiviteti i shfryezimit ne karjerren e trupit Nr 1 ne shkalle parashikohet të jete si me poshtë:

- Ne shkallen +1745m dhe 1735, gati 1 vit me një zbulimim të pergjithshem perj 12000 m³
- Ne shkallet e me poshteme ne të dy trupat prodhimi do të vazhdoje mbi dy vjet ne çdo shkalle si ne prodhim ashtu edhe ne zbulim

b) Elementet gjeometrike të karrieres ne gjandje perfundimtare

Karierra e Trupit Nr 1 Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik të karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike të shkalleve, karierra do të kete formen e një stadiumi me zgjatje JugeLindje Veri Perendim, me parametrat e me poshtëm

- Thellesia e vertikale e karrieres, e ndryshme ne profile maksimalisht 35m;
- Numuri i shkalleve 4(me zhvillim të plote ne të gjithë gjatesine e karrieres);
- Gjeresia e karrieres ne plan ne pjesë e siperme të saj do të jete, 40-50m;
- Gjeresia ne sheshin e poshteme e karrieres (sipas kuotave të shkalleve), 10 m;
- Gjatesia e karrjeres ne pjesen e siperme 135m;
- Gjatesia e karrieres ne pjesen e poshtme 100 m;
- Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi të shtrirjes se karrieres është $50-62^{\circ}$
- Lartesia e shkalles 10m;



- Orientimi i transheve të hyrjeve është gati Juge Perendim Veri Lindje sipas kuotave të shkalleve nga +1745 m deri ne +1715m;

Pasaportat e shpim plasjes për zbulimin dhe frontet e prodhimit llogaritja e lendes eksplozive që do të perdoret ne kariere.

Parashikimi i puneve të shpim plasjes është bere duke patur parasysh faktoret e meposhtem:

- Domosdoshmerine e perdorimit të Lendes Plasese për rrezimin e mineralit të kromit dhe hkëmbore rrethues të tipit të peridotiteve,
- Volumin ditor ne m³ masiv, i cili do të jete 30-50m³;
- Shpimi i birave ne pjesët fillestare të hyrjes ne shkalle dhe ne hapjen e transheve të cekta do të behet me cekic shpues pneumatik dore;
- Birat per kryerjene procesit te mirfillte te zbulimit do te kryhen me sonde

Me poshtë janë dhene llogaritjet perjkatese për percaktimin e pasaporten e shpim plasjes me bira të zakonshme. Ne kete rast parametrat e pasaportes se shpim plasjes do të jene si me poshtë llogaritjet e lendes plasese dhe të parametrave të pasaportes janë bere si me poshtë

Konsumi specific lendes plasese të nevojshme për të rezuar 1 m³ shkemb llogaritet me formulen e meposhtem

$$C = \frac{S \mathcal{E}_{ss}}{\eta_1 \eta_2 \eta_3 \varepsilon}$$

Ku:

η1-Faktori i rezistences;

η2-Faktori i çiftezimit (bashkimit) ;

η3-Faktori i coptimit;

ε –Karakteristikat e eksplozivit

εss-Karakteristikat e shkëmbore

Ne formulen emesiperme parmtrat që do të percaktohen janë :

Faktori i rezistences varet nga pesha vellimore e shkëmbore ρ pasha vellimore e lendes plasese ρe ,

shpejtesiat e detonimit të lendes plaese D dhe e shpejtesia e shperndarje se valeve sizmike ne shkemb C.

$$\eta_1 = \frac{(\rho_e D - \rho C)^2}{(\rho_e D + \rho C)^2}$$

Faktori i çiftëzimit (bashkimit të diametrit të bires së çpimit me diametrin e llokumit të lendes plase) varet nga diametri i shpimit Φ_b dhe diametri i fishekut të lendes plasese Φ_e .

$$\eta_2 = \frac{1}{e^{\Phi_b/\Phi_e} - (e - 1)} = \frac{1}{e^{1.16} - 1.72}$$

Faktori i shkallës së çoptimit të shkëmbore s përcaktohet nga relacioni i mëposhtëm

$$s = \frac{64}{D_M}$$

Ku : D_M permasa e pranuar e coprave në m;
Largësia B e reshtave përcaktohen me formulën

$$B_1 = \sqrt{\frac{\rho_e \pi}{4c}}$$

Largësia midis birave në resht në kontur të punimit llogaritet me formulën

$$s_c = \Phi_b + \left[\left(\frac{\Phi_e}{\Phi_b} \right)^2 \times \frac{\Delta_e \times P_s \times \Phi_b}{6} \right]$$

Llogaritjet sipas rradhës së mësipërme është bërë si për punimet sipërfaqësore edhe ato nëntokesore me anë të cilave janë përcaktuar parametrat e pasaportave të shpimit plasjes në punime

Pasaporta e shpimit plasjes me bira të shkurtra dorë

Parashikimi i punëve të shpimit plasjes është bërë duke patur parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Domosdoshmerinë e përdorimit të Lendes Plasese për rrezimin e gelqerorit;
- Volumin ditor në m³ masiv, i cili do të jetë 60-120 m³;
- Shpimi i birave në pjesët fillestare të hyrjes në shkallë dhe në hapjen e transheve të cekta do të bëhet me cekic shpues pneumatik dorë;
- Në momentin e kryerjes së zbulimit në shkallët e formuara me lartësi 10 m parshikohet të përdoret rrezimit puse sonde

Zgjedhja e shesheve të depozitimit të sterileve, mineraleve ose të nenprodukteve gjatë kryerjes së proceseve të zbulimit, skarifikimit të pjesës së gryer për sisemimn e rruges dhe atyre të prodhimit parashikohet të veprohet si më poshtë:

Për zbulimin: sasia e përgjithshme e zbulimit, për të gjithë karrierën, parashikohet të kryet në 3 vite e gjithë sasia e zbulimit prej gati 31000 m³, që do të dalë nga karierra do të depozitohet në një sipërfaqe prej gati 4500 m² në zonën e caktuar për këto qëllime në jug të karrierës së trupit një dhe poshtë rruges ekszituese që vjen nga sheshi +1715m. E gjithë sasia e sterileve të zbulimit do të ridedepozitohen në brendësi të karrierave të krijuara përkatësisht.

Sasia e sterileve të dalë është e mjaftueshme për rehabilitimin mjedisor të karrierës së krijuara nga shfrytëzimi.

Zgjedhja e mënyrës së shfrytëzimit me punime nëntoke.



Pas llogaritjeve paraprake, rezervat gjeologjike të llogaritura me siper ju nenshtuan llogaritjes se rezervave të nxjerrshme të ndara perkatesisht ne shkalle apo kate si ne tabelat e me poshteme për secilin trup të vendburimit Gjithashtu eshte kryer edhe vleresimi paraprak i rezervave te mineralit dhe koeficienti i zbulimit per pjesen nga profili LXIII ne ate LV Llogaritjet e kryera si dhe thellesia e zhvillimit te rupit xeheror ne zonen e profileve te sipercituar deshmojne per mundesine e shfrytezimit te te rezervave te trupave me nentoke duke aplikuar metoden gjeresisht te perdorur ne rajon dhe ne vendburimete masivit te Bulqizes. Per hapjee dhe pergatitjen e objektit do te shfrytezohen edhe punimete e ndertuar tashme siç eshte galeria Nr 5 dhe traversat apo oxhaqet e ndertuara me pare (shih planimetrine e punimeve dhe projeksionin vertikal)

Punimet e hapjes se vendburimit

Per ti paraprire pergatitjes dhe shfryteimit te rezervave te mineralit te kromit ne trupin e pershkruara me siper ne pjesen gjeologjike tjeter parashikohet te kryhen kryesisht punime kapitale si me poshte:

- Ringritja e dhe riparimi i galerise Nr5
- Ringritja e dhe riparimi e traversave apo oxhaqeve tendryshme ne galerine Nr5
- Hapja dhe pergatitja e vendburimit me perdorimin e galerise Nr 5 .
- Hapjen e nje traverbanku nga siperfaqja qe do te lidhet me galerine Nr 5.
- Ndertimi galerise fushore ne kuoten +1690 m si dhe lidhjen e galerise Nr 5(+1660) me ate +1690 me anen e oxhaqeve per kalimin e tpuonjesve dhe transportin e mineralit dhe te sterilit.

Projektimi i punimeve te reja eshte bere duke pasur parasysh:

- Kompletimin dhe berjen funksionale te skemes se hapjes se secilin bllok ose prerje
- shfrytezimi;
- Lartesia e katit e pranuar sipas eksperiences se shfrytezimit te vendburimeve te kromit ne vendin tone eshte 30m. Zgjedhja e kesaj lartesie eshte bere duke mare parasysh dhe elementet es htruarjes se trupave si dhe trashesine dhe tektoniken e pas mineralizimit e cila siç duket nga planimetrite e punimeve dhe prerjet eshte mjaft e zhvilluar ;
- Venien ne funksionim sipas normave te RrTS dhe te ajrimit te kompleksit te punimeve te hapjeas dhe me pas te pergatitjes dhe shfrytezimit ;
- Sigurimin e rradhes dhe drejtimit te shfrytezimit duke pasur parasysh pozicionin e blloqeve te kromit ne raport me njeri tjetrin si dhe shperndarjen e rezervave ne katet e ndryshme te trupave te llogaritura ne tabelat e mesiperme;
- Shperndarjen ne plan dhe hapsire te rezervave te nxjerrshem
- Fillimin e prodhimit nga nentoka ne vitin e dyte te marjes se lejes se shfrytezimit

Per plotsimin e kushteve te me siperme parashikohen te kryhen punimet e meposhteme:



Tabela Nr 3.7 Punimet qe parashikohen te hapen

Nr	Emertimi I punimit	Njesia	Sasia ,ml	Kosto Usd/ml	Vlera USD
1	Traverbanku kryesor nga siperfaqja , +1660	ml	445	496.2	220790
2	Fushor +1660	ml	95	322.5	30638
3	Fushori +1690 (kat ndermjetes)	ml	255	322.5	82238
4	Traversa +1660	ml	70	209.6	14674
5	Traversa +1690	ml	90	209.6	18866
6	Oxhaqe +1660	ml	51	85.7	4373
7	Oxhaqe +1690	ml	50	85.7	4287
8	Oxhaqe paralel per lidhjen e +1660 me +1690	ml	70	85.7	6002
9	Oxhaqe paralel per transport minerali dhe sterili +1690-1660	ml	60	85.7	5145
10	Shpenzime per riparimin egalerise 5				5160
10	Shuma				392173

Investimet e mesiperme do te realizohen pjeserisht gjate aktivitetit dhe kryesisht ne panelin +1690m shuma e parashikuar deri ne perfundimin eafatit eshte 321163 USD

Tabela Nr 3.8 Preventivi i koston se galerise se nenkatit

No.	Emertimi	Njesin	Normativa	Çmimi USD/njesi	Vlera, USD
1	Materialet e normuar	USD/ml			105.46
a	Lende plasese	kg/ml	9.25	2.52	23.31
b	Kapsolla elektrike	piece/ml	10	0.92	9.20
c	Tel linje	ml/ml	0.25	0.25	0.06
d	Lende drusore ose te tjera	ml/ml	0.26	180	46.80
e	Koka shpimi	piece/ml	0.36	46.55	16.76
f	Baromina	piece/ml	0.03	36	1.01
g	Diezel	l/ml	4.60	1.8	8.10
h	Lubrifikant	USD/ml	0.09	2.500	0.23
2	Energji elektrike	kwh/ml	38	0.16	6.08
3	Pagat direkte	USD/ml			55.1
4	Shpenzime kompanie	USD/ml			5.8
5	Kosto	USD/ml			172.4

Tabela Nr 3.9 Preventivi i kostos se traverbankut +1660

No.	Emertimi	Njesin	Normativa	Çmimi USD/njesi	Vlera, USD
1	Materialet e normuar	USD/ml			173.32
a	Lende plasese	kg/ml	16.5	2.52	41.58
b	Kapsolla elektrike	piece/ml	18	0.35	6.30
c	Tel linje	ml/ml	0.25	0.25	0.06
d	Lende drusore ose te tjera	m3/ml	0.25	180	45.00
e	Koka shpimi	piece/ml	0.98	46.55	45.62
f	Baromina	piece/ml	0.36	36	12.96
g	Diezel	l/ml	12	1.76	21.12
h	Lubrifikant	kwh/ml	0.3	2.25	0.68
2	Energji elektrike	l/ml	120	0.16	19.20
3	Paga shtesa	USD/ml			140
4	Materiale te tjera armatimi	USD/ml			158.00
5	Shpenzime kompanie	USD/ml			5.60
6	Kosto				496.16

Tabela Nr 3.10 Preventivi i kostos se Oxhakut vertikal

No.	Emertimi	Njesin	Normativa	Çmimi	Vlera,
1	Materialet e normuar	USD/ml			53.81
a	Lende plasese	kg/ml	6.8	2.52	17.14
b	Kapsolla elektrike	piece/ml	8	0.92	7.36
c	Tel linje	ml/ml	0.03	2.5	0.08
d	Lende drusore ose te tjera	ml/ml	0.09	180	16.20
e	Koka shpimi	piece/ml	0.28	46.55	13.03
f	Baromina	piece/ml	0.018	36	0.65
g	Diezel	l/ml	8.60	1.76	15.1
h	Lubrifikant	USD/ml	0.17	2.50	0.43
2	Energji elektrike	kwh/ml	22	0.16	3.52
3	Pagat direkte	USD/ml			25.9
4	Shpenzime kompanie	USD/ml			2.5
5	Kosto	USD/ml			85.75

Sistemi i shfrytezimit

Sistemi i shfrytezimit i perdorur dhe ai qe parashikohet te perdoret ne varesi te kushteve teknikominerare eshte ai me galeri nenkati:

- Gjatesia mesatare e bllokut 20-40 m



- Lartesia e pjerret e katit 32-38m
- Permasat mesatare te bllokut 25mx38mx 1.2m
- Metrazhi specifik i punimeve minerare horizontal e te pjerat 0.091ml/ton
- Drejtimi i tavanit me hapsira te hapura
- Humbjet 12.6% dhe varferimi 10.2%
- Ajrimi i minieres

Shfrytezimi i rezervavete mbetura te objektit te kromit Thekna Verilindore është vazhdimi i shfrytëzimit në thellësi i saj duke perdorur punimet minerare te hapura me pare te cilat, nga vrojtimit e bera duket te jene ne gjendje reklativisht te mire si dhe duke ndertuar punime te reja . Kështu që për hartimin e projektit të ajrimit të zhvillimit me në thellësi të punimeve të minierës jemi mbështetur në të dhënat e eksperiencës së deritanishme të vetë ndërmarrjes, të dhënave të literaturës dhe rregullores së teknikes se sigurimit. Në mbështetje të këtyre të dhënave, në këtë kapitull, jemi përpjekur të plotësojmë parimet bazë të ajrimit për një ajrim të plotë, efektiv, ekonomik dhe që plotëson kërkesat e sigurimit teknik. Në llogaritjen e skemës së ajrimit kemi marrë parasysh depresionin minimal dhe atë maksimal.

Duke patur parasysh projektin e zbatuar elementet kryesorë të ajrimit dhe luftës kundër pluhurit janë si më poshtë:

- Skema e përgjithëshme e ajrimit të minierës është përshkruar duke patur parasysh punimet kryesorë të hapjes së minierës dhe radhën e kryerjes së tyre. (shih skemen hapsinore). Brenda çdo nivelii punimet e hapjes dhe përgatitjes për çdo bllok janë parashikuar që të sigurojnë ajrimin e froteve dhe të punimeve në mënyrë të pamvarur.
- Sasia e ajrit është llogaritur duke patur parasysh të gjithë elementet e kontrollit dhe të përcaktimit të saj, si fuqia puntore në turnin më të madh, volumin maksimal të prodhimit konsumin e lëndëve plasëse.

Llogaritjet e ajrimit të parqitura me poshtë janë kryer për fazen përfundimtare të minierës
Përcaktimi i sasise së ajrit

Përcaktimin e sasise së ajrit e është bërë sipas faktoreve të mëposhtëm:

A. Në bazë të numrit me të madh të punonjesve për ndresën me të ngarkuar

$Q = k \times n \times q$ (m³/min) ku:

n = 14 numri i punëtoreve

k = 1.5 koeficienti i humbjeve të sistemit

q = 4 m³/min sasia e ajrit për një punëtor

$Q = 1.5 \times 4 \times 14 = 84 \text{ m}^3/\text{min} = 1.4 \text{ m}^3/\text{sek}$

B. Në bazë të sasise së lendes plasëse.

$$Q = \frac{k}{20000} \times \frac{a \times T \times m \times b}{t}$$

ku: k = 1.5 koeficienti i humbjeve të sistemit

a = konsumi specifik i L.E. 300 gr/ton

T = prodhimi ditor 35ton/24 ore (me gjithë sterilin)



m = përqindje e L.E. që shpërthen menjëherë 40 %

t = koha e ajrimit 30'

$$Q = \frac{1.5}{20\,000} \times \frac{300 \times 35 \times 40 \times 40}{30} = 120 \text{ m}^3 / \text{min} = 2 \text{ m}^3 / \text{sek}$$

C. Në bazë të prodhimit ditor të minierës

$$Q = k \times q_l \times 35 = 1.5 \times 1.5 \times 35 = 79 \text{ m}^3 / \text{min} = 1.3 \text{ m}^3 / \text{sek}$$

k = 1.5 koeficienti i humbjeve të sistemit

q_l = 1, 5 m³:min norma për ton prodhim

D. Në bazë të shpejtësisë së largimit të pluhurave dhe shpejtësisë së lëvizjes së ajrit .

Si shpejtësi e largimit të pluhurave dhe shpejtësisë së lëvizjes së ajrit kemi parasysh rregulloren e Teknikës së Sigurimit. Në bazë të së cilës shpejtësia e domosdoshme për largimin e pluhurave lejohet 0.3 m/sek në fronte shfrytëzimi dhe 0.25 m/sek për punimet.

Tabela Nr 3.11 Përcaktimi i sasisë së ajrit sipas shpejtësisë së RrTS

Nr	Emertimi	Sipërfaqe m ²	Sasia e fronteve	Shpejtësia e lëvizjes m/s	Sasia e ajrit m ³ /sek
1	Fronte shfrytëzimi	5.2	1	0.3	1.56
2	Fronte avancimi				
	- Punime niveli	5.2	1	0.25	1.56
3	Fronte avancimi				
	- Pun. përgatitore	2.25	1	0.25	0.565
4	SHUMA				3.68

$$Q = k \times q = 1.4 \times 3.68 = 5.15 \text{ m}^3 / \text{sek} \sim 5 \text{ m}^3 / \text{sek}$$

Llogaritja e depresionit të sistemit

Para së të llogaritim depresionin e sistemit për variantin e parë llogaritim depresionin natyral.

$$h_n = \frac{346 \times H (t_2 - t_1)}{(273 + t_2) \times (273 + t_1)}$$

ku:

H – diferenca e kuotave të hyrjes dhe të daljes së ajrit

t₁ – temperatura e ajrit në hyrje

t₂ – temperatura e ajrit në dalje

Nga zevendesimet në formula të mësipërme depresioni natyral rezulton -22 mm H₂O deri +56 mmH₂O ose 560 Pa

Për të llogaritur depresionin e sistemit përdorim formulën:

$$h = \frac{\alpha L \times P \times Q^2}{S^3} \quad \text{në mm H}_2\text{O (Ose Pa) ku:}$$

α--koeficient i rezestences aerodinamike të punimeve

L – Gjatësia e punimeve në të cilat do kalojë ajri (ml)


P – perimetri i punimeve (ml)

S – sipërfaqja e seksionit terthor të punimeve (m²)

Q – sasia e ajrit që kalon në punim m³/sek.



Adresa: Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durrës
Cel +355 69 37 67 595
E-mail: green-studio@hotmail.com



Ndryshimet përkatëse, rrjedhje e ndryshimeve në projektin e hapjes do të jenë objekt i projekteve teknike dhe të zbatimit.

Nga llogaritjet e kryera për sistemin e ajrimit në thellësinë dhe shtrirjen maksimale rezulton 100 mm H₂O

Kjo vlerë është marrë duke i shtuar depresionit të llogaritur vlerën e depresionit natyral i cili në varesi të temperaturave brenda dhe jashtë është nga 25 mm H₂O

Karakteristikat e ventilatorit kryesor do të jenë:

- $Q = 5 \text{ m}^3/\text{sek}$, $H = 1300 \text{ Pa}$, $N = 15 \text{ kw}$
- Ajri në minierë për pjesën me të sipërme të minierës do të hyjë nga galeria Nr5 dhe traverbanku që lidhet me të në kuotën +1660, do të ngjitet në oxhaqet për ajrosjen e katit ndermjetes +1690m dhe me pas do të dalë në sipërfaqe nepermjete furnelit të ajrimit.
- Ajrimi i kësaj pjese është i lehtë dhe mund të përhallohet edhe nga ajrimi natyral
- Pavaresisht nga kjo për ajrimin e kësaj pjese të minierës është parashikohet të instalohen një ventilatore lokal.
- Nevojat për materiale makineri e pajisje shpimi, ngarkimi dhe transporti në nentoke

Teknologjia e shfrytëzimit që parashikohet të përdoret në këto miniere do të jetë ajo klasike:

- Rrezimi me bira minash të hapura me çekiç pneumatik në kollone (tip WUP 22 ose 7545)
- Ngarkimi në front me lopate dore
- Transportit në front për gravitet
- Transporti në galeri me vagona të kthyeshem me krahe
- Armatimi i frontit dhe punimeve përgatitore, kryesisht me lende druri

Për të realizuar kryerjen e punimeve minerare, kryerjen e proceseve të ndryshme ndihmese dhe të prodhimit do të duhen :

A Materiale

Tabela Nr 3.12 Nevojat për materiale

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
				Usd/ml	Usd
1	Kabllo elektrik	ml	200	15	3000
2	Tubo çeliku	ton	1	1300	1300
3	Tubo gome	ml	300	1.2	360
4	Shina	ton	3	1300	3900
5	Baromin	cope	5	65	325
6	Devijues shinash	Cope	1	200	200
7	Shuma				9085

B Makineri e Pajisje

Tabela Nr 3.13 Nevojat per makineri e pajisje

Nr	Emertimi i makinerise	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
				USD/cop	USD
1	Ventilator lokale N= 11.5Kw D=600mm	Cope	2	2100	4200
2	Ventilator qerndror N= 15Kw	Cope	1	8000	8000
3	Çekiçe pneumatik	Cope	2	680	1360
4	Vagona te kthyeshem 0.3 m3	Cope	4	1200	4800
5	Shuma makineri e pajisje				15560

Zgjedhja e shesheve te depozitimit te sterileve, mineraleve ose te nenprodukteve gjate aktivitetit te miners parashikohet te depozitohen perkatesisht sasite e sterileve si me poshte:

- Nga punimet minerare te reja 3 000 m³
- Nga seleksionimi me dore 1500 m³
- Nga pastrime e sistemime te ndryshme 500 m³

Vendi i depozitimit te sterileve eshte percaktuar te jete sheshit industrial te percaktuar ne harte brenda siperfaqes ne studim

Lidhja me rrjetin elektrik

Me rrjetin elektrik do të kemi lidhje në kabinën elektrike që do të vendoset në objekt nga OSHEE-ja e zones.

Furnizimi me ujë

Aktiviteti disponon depo me uje nga burimet ujore qe ndodhen ne afersi te aktivitetit minerar por ne baze te proceseve te punes uji nuk ndikon ne funksionimin e instalimit.

Ndikimet në ujrat sipërfaqësor.

Zbatimi i ketij projekti nuk lë shkas për ndotjen e ujerave rrjedhëse sipërfaqesore nga ndotës të ndryshëm si karburantet, lëndët helmuese etj. Nuk pritët të ndodhë qoftë dhe ndonjë ndotje indirekte që mund të rezultojë nga shkarkimet në tokë, e me pas të shpëlahen nga rreshjet, pasi ato nuk do të përdoren gjatë zbatimit të projektit apo rehabilitimit të territorit, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

Ndikimet në ujrat nëntokësor.

Zbatimi i projektit mund të ndikojë disi në zgavrimim e metejshëm të çarave të argjilës nga rritja e sasisë të ujerave sipërfaqësorë te rreshjeve për shkak të reduktimit të materialit të gjelbër që mbulon vende-vende territorin, duke rritur kështu kapacitetin e infiltrimit.

Zhurmat

Zhurma në këtë objekt do të shkaktohen vetëm nga procesi i nxierrjes se mineralit te kromit me përdorimin e lëndës plasëse të cilat do të jenë shumë të vogla të cilat pothuajse nuk dëgjohen fare pasi procesi realizohet totalisht nentoke dhe larg qendrave te banuara.

Zhurmat e tjera do të jenë nga mjetet e ngarkimit dhe atyre të transportit. Zhurmë tjetër do të jete ajo e mjeteve të transportit, të cilat numri i tyre do të jetë shumë i vogël dhe zhurmat janë të papërfillshme dhe të kontrolluara.

Niveli i zhurmave të mjeteve të transportit është i atij niveli që nuk influencon fare si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat përreth tij.

Të administrojn mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndërtuese, duke marre masa:

Mbetjet të largohen çdo ditë nga sheshi i ndërtimit dhe të dergohen në vend-grumbullimet e përcaktuara nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore. Transporti i tyre të bëhet në orët me trafik të pakësuar. Për transportimin e materialeve dhe të mbetjeve të përdoren makina të mbuluara dhe që nuk rrjedhin. Të pastrohen menjëhere rrjedhjet, derdhjet, pikimet për të parandaluar ndotjen e tokës.

Rehabilitimi i territorit

Te gjitha masat rehabilituese do te konsistojne ne:

- Uljen e erozionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me specie natyrore
- Rritjen e vlerave vizuale dhe krijuese te territorit qe mbulon subjekti

Per pyllzimin e siperfaqeve te zhveshura do te hartohet nje miniprojekt i detajuar nga specialistet perkatese

Rehabilitimi i tokes

Nese do te nevojitet stabilizimi i zones qe do te pyllzohet, do te perdoret pastrimi nga mbetjet inerte dhe do te mbushet 10 cm me humus. Mulciritimi do te sherbeje ne uljen e humbjes se fares nga largimi prej aktivitetit atmosferik (reshjet, ererat, etj) si dhe per uljen e aktivitetit erodik per sa kohe objekti eshte i pa zhvilluar mire.

Rehabilitimi i plote i mjedisve te territorit

Mbjellja e siperfaqes

- Mbjellja e territorit me gradona
- Blerja e fidaneve te pishes ne fidanishte cilesore
- Mbjellja e fidaneve dhe sherbimi kulturor i tyre per 10 vjet

Nga veterehabilitimi i habitateve me perparesi do te marre rritja e te gjitha gjallesave si shtimi dhe rritja e shpendeve, zvaranikeve etj, njekohesisht do te shtohen edhe rezervat



ushqimore per gjitaret e larte si lepuri, dhelpra, ujku, etj, per rrjedhoje do te rritet mundesia e pranise se shtimit te qelbesit dhe buklit (nuses se lales)

Kanalizimi

Kanalizimi do te behet per disiplinimin e ujrave nentokesore qe do te dalin nga galleria si dhe ujrave siperfaqesore qe do te shkaktohen nga rreshjes.

Keto kanalizime do te bejne qe rrjedha e ujrave te behet per force te rendeses, duke penguar ne kete menyre depertimin gradual ne toke.


Ne te gjithe territorin, ku pershkohet nga proskat do te ndertohen mure guri te thate dhe gardhe cifte dhe teke.

Përgatiti Raportin;

Green-Studio

Ing Ervis MALAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 4935 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 361

ÇERTIFIKATË


Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ERVIS MALAJ

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.


MINISTRI

Lefter KOKA



GREEN-STUDIO

Adresa: Lagja 7 Rr. Hajdar Demiri Durrës
Cel +355 69 37 67 595
E-mail: green-studio@hotmail.com



Green-Studio



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPIERMARRJES

LICENCË



LN-9472-04-2015	NUIS/NIPT: L51607502C
Subjekti: Ervis Malaj	
Adresa: Durres, DURRES, Durres, Lagjja 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kati i parë.	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 12/02/2016	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Adresa Durres	
Katëshi, zona kadastrale	
Kodi: III.2.A (1+2)	
Posta e lëshimit:	
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislativin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislativin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënskrimi i porteilit:

JULIT TRASK



Vepërprishtaritë e objektit gjendet në adresën: [illegible]